



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



**FSH.nr. 211/19**

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Blerim Dina– Kryetar, z. Nuhi Paçarizi –Referues, z. Goran Milenković–Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE “EUROPRINTY” SHPK-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE NTP “VERTIGO” -Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me material për zyrë”, me nr. të prokurimit: HJ-19-010-121, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – K.R.U Hidroregjioni Jugor SH.A /HJ/, më datën 11.06.2019 mori këtë:

**V E N D I M**

**I. APROVOHET**, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “EUROPRINTY” SHPK - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me material për zyrë”, me nr. të prokurimit: HJ-19-010-121, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – K.R.U Hidroregjioni Jugor SH.A /HJ/.

**II. ANULOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës me titull “Furnizim me material për zyrë”, me nr. të prokurimit: HJ-19-010-121, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – K.R.U Hidroregjioni Jugor SH.A /HJ/, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

**III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “EUROPRINTY” SHPK - Prishtinë aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### ARSYETIM

Data e njoftimit për kontratë është bërë me dt: 01.03.2019

Lloji i procedurës së aplikuar:Procedurë e hapur

Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:Kontratë publike, furnizim

Vlera e parashikuar e kontratës: 116.287,23 €

Data e hapjes së ofertave është bërë me dt: 26.03.2019

Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave është bërë me dt:13.04.2019

Data e njoftimit mbi vendimin e AK-së, është bërë me dt: 25.04.2019

Data e kërkesës për rishqyrtim është bërë me dt: 26.04.2019

Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim është bërë me dt: 08.05.2019.

Operatori ekonomik ankues “EUROPRINTY” SHPK-Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 13.05.2019, me nr. 221/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me material për zyre”, me nr. të prokurimit: HJ-19-010-121, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ – K.R.U Hidroregjioni Jugor SH.A /HJ/, duke pretenduar se :

- Autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenin 7, 59 dhe 61 Ligjit për Prokurim Publik

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 20.05.2019, ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti Shqyrtues në raportin e dt: 30.05.2019, konstaton se AK-së, ka kërkuar përmes Letrës standarde për sqarime të çmimeve ka kërkuar sqarime nga OE “EUROPRINTY” SHPK, për çmim jo normalisht të ulët.



Eksperti shqyrtues sqaron se me dt:15.04.2019, i jep sqarime AK-së në lidhje me çmimet jo normalisht të ulët.

Eksperti shqyrtues konstaton se AK-së, me dt:25.04.2019, përmes Letrës standarde për tenderuesit e eliminuar i drejtohet OE ankues "EUROPRINTY" SHPK, ku i thotë: Oferta juaj konsiderohet jo normalisht i ulët sipas rregullores B57.

1. Është plotësuar kushti i parë sepse janë pranuar 7 oferta të përgjegjshme;
2. Plotëson edhe kushtin e dytë (30%) sepse çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se mesatarja e tenderëve;
3. Plotëson edhe kushtin e tret – çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi i tenderit të dytë më të ulët;

Andaj lidhur me arsyen e eliminimit nga AK-së, ku e eliminon OE ankues me arsyetimi se ka ofruar tender me çmim jo normalisht të ulët, si dhe duke pasur parasysh pretendimin OE ankues ku pretendon se oferta e tyre nuk është ofertë me çmim jo normalisht të ulët, eksperti shqyrtues pas analizimit të çmimeve të ofertave të përgjegjshme, sipas Rregullores për çmime jo normalisht të ulët të aprovuar nga KRPP, rezulton se pragu për tu konsideruar ofertë me çmim jo normalisht të ulët janë të gjitha ofertat deri në vlerën prej 35,788.19 €.

Eksperti shqyrtues sqaron se gjatë vlerësimit nuk është marrë parasysh neni 61 të LPP-së, si dhe nuk është marrë parasysh Rregullorja për çmime jo normalisht të ulët e aprovuar nga KRPP-ja.

Operatori ekonomik pretendon se është qysh para publikim të këtij tenderi, shihet çart se ky tender i është dedikuar për OE fitues, pasi që tek përshkrimi i çmimeve në formatin Excel figuron emri i OE "VERTIGO", dhe ky pretendim mund të verifikohet edhe nga eksperti shqyrtues i caktuar për këtë lëndë.

Duke u bazuar në pretendimin e OE ankues "EUROPRINTY" SHPK, eksperti shqyrtues sqaron se pas analizimit të këtij pretendimi dhe pas analizimit të përshkrimit të çmimeve në formatin Excel, të ngarkuar në e-prokurim, është e vërtetë që në fund të këtij përshkrimi del shënimi Vertigo .

Andaj duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar (për arsyen që u cekura më lartë tek përgjigje), dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Operatori ekonomik OE ankues "EUROPRINTY" SHPK –Prishtinë, përmes parashtresës me shkrim të datës: 30.05.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues K.R.U Hidroregjioni Jugor SH.A /HJ/, përmes parashtresës me shkrim të datës: 03.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 11.06.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik ankues, eksperti shqyrtues i OSHP-së, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesja e OE-së znj. Gashi deklaroj: Qëndrojmë në tërësi pran ankesës pajtohem me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi AK-së z. Kaçamaku deklaroj: Është bere një gabim teknik në procesverbalin ku kanë qen gjashtë (6) OE dhe komisioni ka bere shtatë (7), dhe këtu ne e kemi llogarit me rregulloren B57 dhe OE "Europrinti" ka dal me çmim jonormalisht te ulet dhe ka qen me poshtë 30 % me e ulet se gjashtë (6) OE te përgjegjshëm Faza e dyte është 30 % dhe faza e trete është 10 % me poshtë dhe i ka plotësuar te 3 kushtet me qen me ulet, dhe e pranoj qe e kemi bere këtë gabim teknik dhe pajtohem me pikat tjera te ekspertit vetëm me piken 4 nuk pajtohem sepse është bere gabim teknik, njësia kërkuese prej kontratave te me hershme i ka emrat e OE-ve.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti Shqyrtues z. Muhadri deklaroj: Qëndroj prapa raportit te dorëzuar.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e OE-së znj. Gashi deklaroj: Kërkojmë qe te aprovohet ankesa jon dhe lënda te kthehet ne rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së z. Kaçamaku deklaroj: Kërkojmë nga paneli qe kjo lende te kthehet ne rivlerësim.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron



se AK-së, ka kërkuar përmes Letrës standarde sqarimin e çmimeve nga OE ankues, ndërsa me dt:15.04.2019, OE ankues “EuroPrinty”-Shpk jep sqarime autoriteti kontraktues K.R.U Hidroregjioni Jugor SH.A /HJ/, në lidhje me çmimet jo normalisht të ulët.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues, me dt:25.04.2019, përmes Letrës standarde për tenderuesit e eliminuar i drejtohet OE ankues “EUROPRINTY” SHK, ku thuhet si në vijim: Oferta juaj konsiderohet jo normalisht i ulët sipas rregullores B57.

1. Është plotësuar kushti i parë sepse janë pranuar 7 oferta të përgjegjshme;
2. Plotëson edhe kushtin e dytë (30%) sepse çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se mesatarja e tenderëve;
3. Plotëson edhe kushtin e tret – çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi i tenderit të dytë më të ulët;

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se pas analizimit të çmimeve të ofertave të përgjegjshme, sipas Rregullores për çmime jo normalisht të ulët të aprovuar nga KRPP, rezulton se pragu për tu konsideruar ofertë me çmim jo normalisht të ulët janë të gjitha ofertat deri në vlerën prej 35,788.19 €. Andaj gjatë vlerësimit nuk është marrë parasysh neni 61 i LPP-së, si dhe nuk është marr parasysh Rregullorja për çmime jo normalisht të ulët e aprovuar nga KRPP-ja.

Sa i përket pretendimit të OE ankues “EuroPrinty”-Shpk se qysh para publikim të këtij tenderi, shihet çart se ky tender i është dedikuar për OE fitues, pasi që tek përshkrimi i çmimeve në formatin Excel figuron emri i OE “VERTIGO” tash i rekomanduar për kontratë. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se pretendimi i lartpërmendur qëndron për faktin se pas analizimit të këtij pretendimi dhe pas analizimit të përshkrimit të çmimeve në formatin Excel, të ngarkuar në e-prokurim, është e vërtetë që në fund të këtij përshkrimi del shënimi Vertigo.

Paneli shqyrtues sqaron se gjatë seancës për shqyrtim kryesor përfaqësuesi i autoriteti kontraktues pajtohet që është bërë një gabim teknik në procesverbalin nga ana e komisionit vlerësues ku nuk është zbatuar rregullorja B57, në mënyrën e duhur pasi që komisioni ka llogaritur që ka qenë shtatë (7) operator ekonomik përderisa kanë qenë vet gjatë (6) nga ta, andaj kërkon nga paneli që kjo lende të kthehet në rivlerësim.

Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues nuk e ka zhvilluar procedurën siç parashihet tek Rregullat për Tenderët Jo-normalisht të Ulët dhe konform nenit 61 të LPP-së, njëheri ekzaminimi,

vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk e bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së. Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave të merr parasysh nenin 61 të LPP-së, dhe njëkohësisht ti përmbahet në detaje Rregullores për Tenderët Jo-normalisht të Ulët dhe procedurës inter partes.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues obligon autoritetin kontraktues që të zbatojë të gjitha dispozitat e LPP-së, dhe njëkohësisht ti merr parasysh të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

#### **Vendimi t'i dorëzohet:**

1x1 AK – K.R.U Hidroregjioni Jugor SH.A /HJ/,  
1x1 OE –“EUROPRINTY” SHPK- Prishtinë  
1x1 Arkivës së OSHP-së;  
1x1Për publikim në web- faqe të OSHP-së.

